

Në bazë të nenit 10, paragrafi (8) të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007 88/ 2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013 dhe 44/2014, 192/2015, 192/2015, 30/2015 dhe 30/201 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 180/2019 dhe 103/2021) nenit 19, paragrafi (8) dhe nenit, 20 paragrafi (8) të Ligjit të Sigurimit Pensional Vullnetar me Financim Kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 103/2021), Këshilli i ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimit Pensional me Financim Kapital në seancën e mbajtur më 27.2.2023, solli:

## **Rregullore për metodologjinë e përlllogaritjes së mjeteve personale të shoqërisë pensionale**

### **Neni 1**

Kjo rregullore përcakton metodologjinë për përlllogaritjen e mjeteve personale të shoqërisë për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme, shoqërisë për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe shoqërisë për menaxhimin e fondeve pensionale vullnetare (në tekstin e mëtejme: shoqëria pensionale).

### **Neni 2**

(1) Mjetet personale të shoqërisë pensionale përlllogariten si shumë e elementeve të mëposhtme:

a) Vlera e emetimit e aksioneve të zakonshme të emetuara të shoqërisë pensionale, respektivisht kryegjëja e paguar, (vlera nominale e aksioneve të zakonshme të emetuara përkatësisht e rritur me preminë aksionare);

b) Rezervat e shoqërisë pensionale si përmbledhje rezervash ligjore, statutore dhe rezerva të tjera;

c) Shuma e fitimit të akumuluar dhe fitimit sipas periudhës kontabël, edhe atë:

- fitimi i akumuluar për llogari vjetore për vitet e mëparshme, i cili nuk është i ngarkuar me asnjë detyrim apo humbje, e që deklarohet në bilanc dhe konfirmohet nga një revizor i pavarur dhe nga organi drejtues i shoqërisë pensionale dhe

- fitimi nga veprimtaria e shoqërisë pensionale (në bazë neto) që krijohet gjatë vitit dhe përcaktohet nga një përlllogaritje periodike e reduktuar me një të tretën, me përjashtim të fitimit të rishikuar që njihet në shumën e plotë.

(2) Si zëra të zbritshëm nga mjetet personale të shoqërisë pensionale, të përcaktuara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, konsiderohen:

a) Shuma e humbjes së bartur nga vitet e kaluara të biznesit dhe e humbjes nga puna aktuale, përkatësisht:

- humbje të bartura të shoqërisë pensionale nga vitet e kaluara të punës dhe

- humbje nga veprimtaria e shoqërisë pensionale e cila krijohet gjatë vitit dhe përcaktohet me përlllogaritje periodike;

b) Shuma e shpenzimeve të paguara për periudhat e ardhshme dhe mbledhjen e të ardhurave të humbura (AVR) me përjashtim të interesit të përlllogaritur dhe të papaguar nga depozitat e dhëna dhe investimet në letrat me vlerë kreditore dhe

c) Mjetet jomateriale.

### **Neni 3**

Pozicionet që janë pjesë e fondeve personale të shoqërisë pensionale duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kryegjëja duhet të paguhet plotësisht dhe pa kushte në para;

b) Fondet personale të jenë të pakthyeshme;

c) Gjatë funksionimit të shoqërisë pensionale, fondet personale janë të disponueshme menjëherë dhe plotësisht për të mbuluar humbjet e shoqërisë pensionale dhe

d) Në rast falimentimi ose likuidimi të shoqërisë pensionale, fondet personale janë plotësisht dhe pa kufi për të mbuluar humbjet e shoqërisë pensionale dhe detyrimet ndaj kreditorëve të saj.

#### Neni 4

Shoqëria pensionale i dorëzon Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve Pensionale me Financim Kapital raport mbi mjetet personale të shoqërisë pensionale të paraqitur në Shtojcën nr. 1, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, në një tabelë excel. Raporti dorëzohet me gjendjen e ditës së fundit të çdo tremujori të vitit, brenda 30 ditëve nga dita në të cilën përcaktohet gjendja e mjeteve personale të shoqërisë pensionale.

#### Neni 5

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, i mbaron vlefshmëria Rregullores për metodologjinë e përlllogaritjes së mjeteve personale të shoqërisë pensionale të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë 11/2011 dhe 13/2011.

#### Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-357/7

28.2.2023

SH K U P

Kryetari i Këshillit të ekspertëve,  
Maksud Ali

Shtojca numër 1

	<b>Raporti i mjeteve personale</b>	<b>Periudha për ditën --- ----- vitin</b>
A	<b>Vlera e aksioneve të zakonshme të emetuara</b>	
B	<b>Rezerva</b>	
C	<b>Fitimi i akumuluar dhe përfitimi sipas përlllogaritjes periodike</b>	
	<b>Fitimi i akumuluar nga vitet paraprake</b>	
	<b>Fitimi sipas përlllogaritjes periodike</b>	

Ç	Humbja e bartur nga vitet e kaluara të biznesit dhe humbja sipas përlllogaritjes periodike	
	Humbja e bartur nga vitet e kaluara të biznesit	
	Humbja sipas përlllogaritjes periodike	
D	Shuma e shpenzimeve të paguara për periudhat dhe arkëtimi i pamaturuar i të ardhurave (ABP) përveç për kamatën e përlllogaritur, ndërkaq të papaguar	
	Shpenzime të paguara për periudhat e ardhshme dhe arkëtimi i pamaturuar i të ardhurave (ABP)	
	E përlllogaritur, por kamatë e paarkëtuar	
DH	Mjete jomateriale	
	Gjithsej mjete personale A+B+C-Ç-D-DH	
Përqindja e mjeteve personale mbi kërkesën ligjore		
Përqindja e kryegjësë mbi kërkesën ligjore		
Kryegjësja e përcaktuar		
Gjysma e kryegjësë		